



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Datë _____ / _____ / 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **KASTRATI shpk**

Adresa: Lagja 14, Rruga Tirana, Pranë Gjykatës së Apelit, Shkozet, Durrës.

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-57679-05-08-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit: **16,712,750 lekë pa tvsh.**
(gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e shtaëqind e pesëdhjetë)
2. Burimi i Financimit **GRANTI DHE TË ARDHURAT E BASHKISË KAVAJË**
3. Objekti i kontratës: **FURNIZIMI ME KARBURANT**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët** ● oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Gega Center GKG shpk, NIPT K66801001T
Me marzh fitimi 5,9%
2. Kastrati shpk, Nipt-i J61813529P
Me marzh fitimi 16,7%
3. Olsi shpk, Nipt-i J63423463I
Me marzh fitimi 7,2 %
4. Kleidi shpk, Nipt-i K12511603H
Me marzh fitimi 13,7%
5. Mend Oil shpk, Nipt-i L33417202H
Me marzh fitimi 5,7%

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Gega Center GKG shpk
2. Olsi shpk

3. KLEIDI shpk

4. Mend Oil shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik **Mend Oil shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte këto kritere:

- Referuar pikes 2.2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit kërkohet “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.”

Nuk është paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për ti gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Ekstraktit të QKB

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**.

2. Operatori ekonomik **Olsi shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte këto kritere:

- Referuar VKM 970 datë 02.12.2015 KREU II “Për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga koinsumatorët fundor” në pikën 2/ë kërkohet “Regjistrimi i markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave”.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i faktit rezulton se në pikën e shpërndarjes përdorni një markë tjetër tregtare. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga ana juaj nuk vërtetohet asnjë lidhje ndërmjet markës që reklamoni në tabelë dhe markës pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Kjo jo vetëm që bie në kundërshtim me VKM 970 datë 02.12.2015 KREU II “Për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga koinsumatorët fundor” në pika 2/ë, por gjithashtu krijon edhe paqartësi në lidhje me produktin që tregtoni.

- Gjithashtu referuar pikes 2.3.6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karta elektronike të vlefshme deri në përfundimin e plotë të kontratës. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e menaxhimit të karburantit në kohe reale (online) nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet një aplikacioni të vetin ose një Eëbpage.” Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga ana juaj rezulton se programi per menaxhimin online te furnizimit me karburant i perket një marke tjetër tregtare. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga ana juaj nuk vërtetohet asnjë lidhje ndërmjet markës se programit për menaxhimin online te furnizimit me karburant dhe markës pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**.

3. Operatori ekonomik **Gega Center GKG shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte këto kritere:

- Referuar pikes 2.3.2. të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit “Operatori ekonomik ofertues

duhet të paraqesë autorizim për shitje karburanti, lëshuar nga Bashkia përkatëse ose në rastin e stacioneve të karburanteve të ndertuara në autostrada nga ministri përgjegjës për transportin. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.” Ju nuk keni paraqitur asnjë document qe te vertetoni se jeni pajisur me autorizim per shitje karburanti.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**

4. Operatori ekonomik **Kleidi shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Referuar VKM 970 datë 02.12.2015 KREU II “Për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga koinsumatorët fundor” në pikën 2/ë kërkohet “Regjistrimi i markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave”.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe i faktit rezultoi se në pikën e shpërndarjes përdorni një markë tjetër tregtare. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj nuk vërtetohet asnjë lidhje ndërmjet markës që reklamoni në tabelë dhe markës pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit. Kjo jo vetëm që bie në kundërshtim me VKM 970 datë 02.12.2015 KREU II “Për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga koinsumatorët fundor” në pika 2/ë, por gjithashtu krijon edhe paqartësi në lidhje me produktin që tregtoni.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të **refuzuar**.

* * * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Kastrati shpk**, se oferta e paraqitur me me marzh fitimi 16,7% është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.07.2020

Ankesa : Nuk ka patur

Kryetari
Redjan KRALI